



FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS
SPORTSKA STRELJAČKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO SHOOTING SPORT FEDERATION

Adresa: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 43. Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.

Tel: +381 (0) 38 244 473

e-mail: info@fshsk.org, gezim.hazrolli@fshsk.org

RREGULLORE

**PËR PUNËN E KËSHILLIT DREJTUES TË FEDERATËS SË
SHENJËTARISË SPORTIVE TË KOSOVËS**

Prishtinë 11.11.2022

Në bazë të Nenit 22. pika 1.3 dhe Nenit 20 pika 1.4 të Statutit të FSHSK-së të miratuar më datë 11.11.2022 (në tekstin e mëtejshëm – Statuti), Këshilli Drejtues pas hartimit të propozimeve për ndryshim e Rregullores së Punës së Këshillit Drejtues, Kuvendi i FSHSK-së në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 11.11.2022, në Prishtinë, miraton këtë:

RREGULLORE

PËR PUNËN E KËSHILLIT DREJTUES TË FEDERATËS SË SHENJËTARIS SPORTIVE TË KOSOVËS

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1.

Më këtë Rregullore, në hollësi rregullohet mënyra e përgatitjes, thirrjes, mbajtjes dhe dokumentimi i mbledhjeve të Këshillit Drejtues (KD) të Federatës; të drejtat dhe detyrimet e Kryetarit, Nënkyetarit dhe anëtareve të Këshillit Drejtues, organet e tij të punës, Sekretarit të Përgjithshëm, punonjësve të Shërbimit Profesional të Federatës dhe personave të tjerë, që marrin pjesë në mbledhjet e KD-së; si dhe mënyrën e vendimmarrjes, dokumentimit, botimit dhe zbatimit të vendimeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve, të Këshillit Drejtues të Federatës.

Neni 2.

Në punën e tij, KD zbaton detyrat e përcaktuara në Statut, zbaton vendimet e Kuvendit dhe kryen detyrat që i janë besuar nga Kuvendi i Federatës.

Në përputhje me Statutin, vendimet e Kuvendit, programet dhe planet e Federatës, KD mbanë të paktën 4 mbledhje në vit dhe në to shqyrton dhe miraton, planet, raportet dhe aktet tjera normative dhe merr vendime të përshtatshme, konkluzione dhe rekomandime brenda kompetencave të veta.

Mbledhjet e KD thirren dhe mbahen në përputhje me Nenin. 21. Pika 5 dhe 6. të Statutit të FSHSK-së.

Përgatitjet për mbledhje të Këshillit Drejtues

Neni 3.

Mbledhjet e KD thirren dhe rendi i ditës së mbledhjes propozohet nga Kryetari, në mungesë të tij ose më autorizimin e tij, nga njëri nënkryetar i Federatës (në tekstin më poshtë: ftuesi i mbledhjes). Para thirrjes së mbledhjes dhe vendosjes së rendit të ditës, ftuesi i mbledhjes duhet të konsultohet me Sekretarin e Përgjithshëm të Federatës dhe propozuesin, rreth kohës dhe vendit të mbledhjes si dhe rendit të ditës.

Propozimet për thirrjen e mbledhjeve të KD mund t'i dorëzojnë Kryetarit të Federatës: anëtarët e KD, Këshilli Mbikëqyrës (KM), anëtarët e Federatës, organet punuese të KD dhe Sekretari i Përgjithshëm i Federatës.

Neni 4.

Propozimi për mbajtjen e mbledhjes së KD, sipas Nenit 3. paragrafi 2. të kësaj Rregulloreje, i dorëzohet KD, në formë të shkruar dhe si rregull përmban: pyetjen ose problemin që duhet diskutuar në mbledhje, arsyeja dhe qëllimi i shqyrtimit të tyre, propozimi i rendit të ditës, sqarimi i materialit të propozuar (aktet, vendimet, konkluzionet, raportet, planet dhe aktet tjera) të cilat duhen të shqyrtohen dhe miratohen në mbledhjen e KD.

Ftuesi i mbledhjes së KD është i detyruar të thërrasë mbledhjen e KD, brenda 30 ditëve nga marrja e propozimit nga paragrafi 1. i këtij neni.

Ftuesi i mbledhjes është i detyruar që propozimet nga ana e KM, ose nga së paku 4 anëtarë të KD, t'i vejë në rend të ditës, më së largu, brenda afatit prej 15 ditëve.

Neni 5.

Tekstet e materialeve për shqyrtim dhe miratim për mbledhjet e KD, përgatiten dhe i dërgohen KD-së, nga propozuesit, përmes shërbimit profesional, sipas Nenit 3. paragrafi 2. të kësaj Rregulloreje.

KD pranon materiale për shqyrtim edhe nga organet punuese të përhershme ose të përkohshme, dhe të ngarkuarit për ekzekutimin e detyrave individuale, në përputhje me planin e punës së Federatës.

Propozimet dhe kërkesat për shqyrtimin e çështjeve të caktuara, brenda kompetencave të KD-së, mund të dërgohen edhe nga persona të tjerë të interesuar, juridikë dhe fizikë.

Në përputhje me planin e punës dhe sipas vendimeve të Kuvendit dhe të KD-së, në përgatitjen e materialeve për mbledhjet e KD-së, marrin pjesë edhe anëtarët e KD-së.

Neni 6.

Materialet për shqyrtim dhe miratim, të cilat i dorëzohen KD-së nga organet punuese dhe/apo nga personat e përmendur në Nenin 5. paragrafët 1., 2. dhe 3. të kësaj Rregulloreje, do të dorëzohen me shkrim dhe me dokumentin përkatës shoqërues, me një arsyetim të propozimit të cilin KD duhet ta miratojë, si dhe të vendosë për kohën e marrjes të vendimit.

Arsyetimi/shpjegimi i propozimit nga paragrafi i mëparshëm, si rregull, duhet të përmbajë bazën ligjore është propozuar marrja e një vendimi të këtillë, si dhe duhet të përmbajë përshkrimet e sakta lidhur me ligjshmërinë e vendimit, sipas situatave dhe të sigurojë burimet e nevojshme financiare për zbatimin e një vendimi të propozuar.

Neni 7.

Propozimin e rendit të ditës, kohën dhe vendin e mbledhjes, si dhe listën e personave që duhet të thirren në mbledhje, e përcakton ftuesi i mbledhjes, me propozim ose në konsultim me Sekretarin e përgjithshëm, në përputhje me Planin e Punës së Federatës, propozimeve për caktimin e mbledhjes dhe materialet e nevojshme, të dërguara në KD për shqyrtim dhe miratim.

Tekstet e materialit me vendimin e propozuar, konkluzionet, ose rekomandimet që i janë propozuar KD-së për miratim, në konsultim me Kryetarin e Federatës, i përgatitë Sekretari i Përgjithshëm, me iniciativën e tij, në bazë të detyrave të përshkruara, në bazë të vendimit të Kuvendit, ose KD-së, me kërkesë të organizatës në të cilën Federata është anëtar dhe në bazë të propozimit të propozuesit nga Neni 5. i kësaj Rregulloreje.

Materialet e propozuesve nga Neni 5. i kësaj Rregulloreje, si rregull, procedohen dhe vendosen në rend dite dhe shqyrtohen në mbledhjen e KD-së, pas marrjes së mendimit dhe propozimit të vendimit përkatës, konkluzionit, ose rekomandimit, të organit përkatës të punës, të KD.

Neni 8.

Në përputhje me vendimin e ftuesit të seancës, nga Neni 7. paragrafi 1. i kësaj Rregulloreje, Sekretari i përgjithshëm me shërbimin profesional të Federatës, siguron shërbimet administrative, hapësinore, materialin dhe kushtet tjera për mbledhje, duke përfshirë përgatitjen e ftesave dhe materialeve për mbledhje ose seancë, grumbullimin e mendimeve dhe propozimeve të organeve punuese, kompletimin dhe përpunimin e materialeve sipas rendit të ditës, dërgimin e thirrjeve dhe materialeve përkatëse anëtarëve të KD-së dhe personave të tjerë, verifikimin e marrjeve të thirrjeve të dërguara dhe përgatitjen e sallës së takimit.

Neni 9.

Thirrjet për mbledhje të KD, me materiale të përshtatshme, sipas pikave të rendit të ditës, shërbimi profesional i Federatës, ua dërgon anëtarëve të KD-së dhe personave të tjerë, të paktën 7 ditë para datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes.

Thirrja për takimin e përmendur në paragrafin e mësipërm, si rregull përfshinë: informacionin për vendin dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes, agjendën e propozuar, fakte të tjera të rëndësishme për efikasitetin e punës në mbledhje dhe nënshkrimin e ftuesit të mbledhjes.

Mbajtja e mbledhjeve dhe vendimmarrja në seanca

Neni 10.

Takimet e KD janë publike. Një mbledhje e KD, ose pjesë e saj, mundet të jetë e mbyllur për publikun, për të cilën vendos KD.

Takimet e KD i kryeson Kryetari i Federatës, e në rast të pengesës që mbledhjen ta udhëheq Kryetari, atëherë njëri nga nënkryetarët e Federatës do ta udhëheqë mbledhjen (në tekstin e mëtejshëm: Kryesuesi).

Në takimet e KD-së marrin pjesë anëtarët e KD-së, Sekretari i Përgjithshëm i Federatës, Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës (KM), si dhe mund të marrin pjesë drejtorët sportivë të reprezentacionit.

Me ftesë të Kryetarit-Kryesuesit, mund të marrin pjesë edhe anëtarët e trupave punuese, propozuesit, përfaqësuesit e anëtarëve dhe raportuesit sipas pikave individuale për rendin e ditës.

Në seancat publike të KD-së, mund të marrin pjesë përfaqësues të mediave dhe persona të tjerë të interesuar, në përputhje me mundësitë hapësinore dhe të tjera të Federatës.

Neni 11.

Në mbledhjet e KD-së, si rregull, shqyrtohen dhe miratohen vetëm tekstet e shkruara të akteve, vendimeve, planeve, raporteve dhe materialeve të tjera që janë përgatitur dhe paraqitur në përputhje me Nenin 6. dhe Nenin 7. paragrafi 2. të kësaj Rregulloreje.

KD mund të funksionojë dhe të vendosë, nëse në takim janë të pranishëm të paktën 6 anëtarë të KD. Vendimet e KD janë të vlefshme nëse për to në të njëjtën mënyrë, deklarohen të paktën 6 anëtarë të KD.

Materialet që nuk janë të përgatitura dhe dorëzuara në përputhje me Nenin 6. dhe 7. paragrafët 2. dhe 3. të kësaj Rregulloreje, si dhe propozimet, kërkesat dhe parashtrimet e tjera të organizatave ose palëve të tjera të interesuara, kthehen ose dorëzohen tek grupet kompetente të punës, në KD, për një mendim dhe propozim të një vendimi për KD, me përjashtim të rasteve urgjente, pasi KD merr një vendim të veçantë.

Neni 12.

Anëtarit të Këshillit Drejtues i ndërpritet automatikisht mandati, në rast se mungon pa arsye në mbledhjet e Këshillit Drejtues, tri herë, edhe pse është njoftuar me rregull dhe nuk ka dërguar kurrfarë arsytimi të vlefshëm për mungesë në mbledhje.

Neni 13

KD vendos për propozimet, kërkesat dhe materialet tjera të përmendura në Nenin 11. paragrafi 1. i kësaj Rregulloreje, pa debat publik paraprak.

Në fillim të mbledhjes, Kryesuesi do të konstatojë dhe njoftojë të pranishmit, nëse në takim marrin pjesë një numër i mjaftueshëm i anëtarëve të KD-së për vendimmarrje të vlefshme, si dhe të caktojë personin për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.

Nëse konstaton se në takim nuk ka numër të mjaftueshëm të anëtarëve të KD-së për vendimmarrje të plotfuqishme, Kryesuesi, shtynë fillimin e mbledhjes maksimalisht për një orë.

Nëse edhe pas një ore, nuk plotësohen kushtet për funksionim dhe vendim të vlefshëm, Kryesuesi në konsultë me anëtarët prezent të KD-së, e shtynë seancën për një afat tjetër.

Neni 14.

Kur konstaton se në mbledhje marrin pjesë një numër i mjaftueshëm i anëtarëve të KD-së për funksionim dhe vendim-marrje të plotfuqishme, Kryesuesi hapë seancën dhe diskuton rendin e ditës dhe çështjet procedurale.

Gjatë diskutimit për çështjet nga paragrafi i mësipërm i këtij neni, anëtarët e KD-së, Sekretari i Përgjithshëm dhe përfaqësuesit e organeve punuese, mundën të propozojnë ndryshime, ose plotësime të rendit të ditës të propozuar, mënyrën e votimit (publike ose të fshehtë), mbylljen e mbledhjes për publikun, regjistrimin ose përjashtimin e regjistrimit të mbledhjes dhe për çështje të tjera procedurale, për të cilat vendimi merret nga KD.

Pas përfundimit të diskutimit për çështjet e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, Kryesuesi hedh në votim propozimet e paraqitura për rendin e ditës dhe çështjet procedurale, nëse ka.

Neni 15.

KD punon dhe vendosë sipas rendit të ditës të miratuar.

Kryesuesi, për çdo pikë të rendit të ditës, së pari jep vërejtjet hyrëse, nëse është e nevojshme, atëherë ia jep fjalën folësit hyrës, përfaqësuesit të propozimit ose raportuesit, nëse ata ndjekin mbledhjen, pas së cilës hapë debatin për pikën e rendit të ditës.

Folësi hyrës, prezantuesi ose raportuesi, duhet të shpjegojë në veçanti: arsyen, bazën ligjore, kostot, mënyrën dhe efektet e pritura të zbatimit të vendimit të propozuar.

Neni 16.

Në diskutim rreth rendit të ditës, mundën të marrin pjesë anëtarët e KD-së, Sekretari i Përgjithshëm, mysafirët e ftuar, si dhe të ftuarit tjerë: përfaqësues të organeve punuese, propozuesit, raportuesit dhe prezantuesit sipas pikave të rendit të ditës. Personat tjerë në diskutim, mundën të marrin pjesë në mënyrë të jashtëzakonshme, me vendim të KD-së, nëse janë përmbushur kushtet nga Neni 11.1 i kësaj Rregulloreje.

Pjesëmarrësit në diskutimin e përmendur në paragrafin e mësipërm, mundën: të shprehin pikëpamjet e tyre, të iniciojnë propozime dhe kërkojnë ndryshime në rendin e ditës, shqyrtimin e çështjeve të veçanta dhe marrjen e vendimeve ose konkluzioneve për çështje të caktuara; të përkrahin ose sfidojnë miratimin e materialeve dhe amendamenteve të propozuara lidhur me materialet; dhe të propozojnë ndryshimet në tekstet e propozuara.

Përveç nëse KD vendosë ndryshe, diskutimet, me përjashtim të folësit hyrës, raportuesit dhe referentit të materialit për të cilin diskutohet, mund të zgjasin deri në 5 minuta, dhe folësi mundet të flasë vetëm një herë për të njëjtën çështje, metë drejtën për një përgjigje/replikë prej 1 minute.

Neni 17.

Në rast se folësi diskuton për një temë që nuk është temë e rendit të ditës, nuk respekton afatin kohor për diskutim, fyen të tjerët, pengon punën, ose sillet pa respekt në mbledhje, Kryesuesi mundet t'i bëjë një paralajmërim atij.

Nëse folësi të cilit paralajmërimi i është lëshuar, vazhdon me sjelljen e njëjtë, sipas dispozitave të mëparshme të këtij neni, kryesuesi mundet t'ia marrë fjalën dhe nëse më pas vazhdon me

sjelljen e përshkruar, Kryesuesi do ta largojë atë nga mbledhja dhe do ndërpres mbledhjen, derisa të krijohen kushtet për vazhdimin e saj.

Neni 18.

KD merr vendime me votim publik. Përjashtimisht, KD mundet të vendosë të marr vendime të caktuara, me votim të fshehtë.

Nëse KD vendosë për materiale komplekse dhe gjithëpërfshirëse, veçanërisht në propozimet për akte normative, planet dhe raportet e punës ose pasqyrat financiare, si rregull, voton së pari si dokument në parim, pastaj amendamentet/ndryshimet nëse janë propozuar, dhe në fund si dokument në tërësi.

Nëse vendoset për materiale më të thjeshta dhe më të shkurtra, së pari votohen amendamentet e mundshme, dhe pastaj dokumenti në tërësi.

Neni 19.

Kur kërkohet në raste urgjente, ose me qëllim efikasiteti, apo për shkak të rrethanave të tjera të veçanta, për shkak të të cilave s'është e mundur, ose e justifikueshme, të mbahen mbledhjet e KD-së, me praninë fizike të anëtarëve të saj, në mbledhje, Kryesuesi mundet t'i propozojë anëtarëve të KD-së, mbajtjen e mbledhjes elektronike, ose telefonike, duke marr pëlqimin e tyre për propozime specifike, në mënyrë të shkruar, telefonike ose elektronike, deri në një afatë caktuar.

Procesverbalet në mbledhjen elektronike, ose telefonike të KD-së, sipas paragrafit paraprak të këtij neni, për vendimet e marra dhe rezultatet e votimit nga secili propozim, do të bëhen nga Shërbimi Profesional, jo më vonë se 36 orë nga skadimi i afatit, kur janë deklaruar anëtarët e KD-së.

Për punë dhe vendimmarrje të plotfuqishme, në mbledhjet telefonike dhe elektronike, sipas paragrafit 1. të këtij neni, dispozitat e Nenit 11, paragrafi 2. të kësaj Rregulloreje, do të zbatohen në mënyrë analoge.

Përveç procesverbalit sipas paragrafit 2. të këtij neni, Sekretari i Përgjithshëm do të bashkëngjitë një shënim zyrtar, me deklarimet telefonike të anëtarëve të KD-së dhe/ose tekstet origjinale elektronike, apo ato me shkrim të anëtarëve të KD.

Procesverbali, me vendime, konkluzione ose rekomandime, verifikohet në seancën e parë të ardhshme të KD-së.

Neni 20.

Për të kryer në mënyrë efikase detyrat dhe obligimet e besuara, KD mund të krijojë organe punuese të përhershme ose të përkohshme - komisione.

Me aktin mbi themelimin e organeve punuese, KD përcakton përbërjen, kompetencat, fushëveprimin dhe mënyrën e punës së organeve punuese. KD mund të përcaktojë kompetencat, fushëveprimin dhe mënyrën e punës së organeve punuese, të përmendura në paragrafin e mësipërm edhe me një akt tjetër të veçantë dhe mund të delegojë kompetenca të caktuara në organet punuese.

Organet punuese të përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, ndihmojnë KD-nënë përgatitjen, propozimin, miratimin dhe zbatimin e vendimeve dhe kryejnë detyra të caktuara nga paragrafi i mëparshëm, si dhe punë tjera të deleguara/transferuara nga KD.

Për çështjet që vendosen në shkallë të parë nga organet punuese, sipas paragrafit 1. të këtij neni, në shkallë të dytë, vendosë KD.

Neni 21

Për çdo mbledhje të KD-së, do të mbahet procesverbali, ku ceken: koha e fillimit të mbledhjes, anëtarët e pranishëm dhe që mungojnë, personat e tjerë të pranishëm, Kryesuesi, procesmbajtësi, miratimi i rendit të ditës, rrjedhën gjatë mbledhjes sipas rendit të ditës, pjesëmarrjen në diskutim dhe përmbledhjet e diskutimeve të rëndësishme, vendimet e miratuara apo konkluzionet, rezultatet e votimit në të gjitha pikat e rendit të ditës dhe propozimet, në fund, koha e përfundimit të mbledhjes, si dhe elementet tjera të rëndësishme.

Teksti i konkluzioneve dhe vendimeve të shkurtra të KD-së, futen në mënyrë të plotë, drejtpërdrejtë në procesverbal.

Nëse KD ka vendosë për miratimin e materialit të gjerë e të formalizuar, procesverbali duhet të përmbajë vetëm faktet e vendimit, me konstatim se vendimi, ose materiali, që është (ose nuk është) miratuar, është i bashkëngjitur në procesverbal dhe përbën pjesë integrale të saj.

Puna pas përfundimit të mbledhjes të Këshillit Drejtues

Neni 22.

Pas përfundimit të mbledhjes së KD-së, procesmbajtësi është i detyruar të hartojë procesverbalin e mbledhjes dhe ta nënshkruajë brenda 7 ditëve nga dita e mbledhjes.

Procesverbali sipas paragrafit të mësipërm të këtij neni, u paraqitet anëtarëve të KD-së me thirrje për mbledhjen e ardhshme, në të cilën merret vendim për verifikimin e tij, me tekst të plotësuar ose të ndryshuar. Shkresat nga paragrafi i mësipërm, mundën t'u dërgohen anëtarëve të KD-së edhe përmes postës elektronike.

Procesverbali i verifikuar nënshkruhet nga procesmbajtësi dhe Kryesuesi, dhe vendimet e miratuara, konkluzionet dhe dokumentet e tjera të bashkëngjitura në procesverbal nënshkruhen nga Kryesuesi i KD-së, përkatësisht Kryetari.

Vendimet e miratuara dhe të nënshkruara të KD-së, shërbimi profesional i Federatës, është i detyruar t'i publikojë në faqen zyrtare të Federatës, brenda 7 ditëve nga mbledhja.

Neni 23.

Procesverbalet e mbledhjeve të KD-së, me vendimet dhe materialet e miratuara, ruhen përgjithmonë, materialet tjera ndihmëse dhe materiale të tjera të përdorura gjatë seancës, ruhen për 5 vjet.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 24,

Zbatimi i dispozitave të kësaj Rregulloreje të Punës, në përgatitje për mbajtjen e mbledhjeve dhe pas përfundimit të mbledhjeve, do të menaxhohet nga Sekretari i Përgjithshëm, ndërsa me mbajtjen e mbledhjes dhe marrjen e vendimeve të KD-së, udhëheq Kryetari-Kryesuesi i mbledhjes.

Për çështje që nuk janë rregulluar me këtë Rregullore, drejtpërsëdrejti zbatohet Statuti i Federatës, ose KD drejtpërdrejt vendosë për ato çështje, në mbledhje, në përputhje me Statutin dhe Rregulloret në fuqi.

Neni 25

Kjo Rregullore hynë në fuqi menjëherë pas miratimit të saj. Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon së zbatuari Rregullorja e punës e KD,e datës **28.01.2018**

Prishtinë, 11.11.2022

Kryetari i FSHSK-së
Gëzim Hazrolli

